

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME VENDIN PRITËS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ZYRËS RAJONALE PËR BASHKËPUNIM RINOR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR), palë nënshkruese të së cilës janë Republika e Shqipërisë dhe Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor.

Qëllimi i marrëveshjes me vendin pritës është të përcaktojë rregullat e funksionimit të ZRBR-së, statusin ligjor, si dhe privilegjet dhe imunitetet e stafit që do të ushtrojë aktivitetin në këtë strukturë.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje synohet të formalizohet marrëveshja ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor, bërë në Paris, më 4 korrik 2016, për t'i hapur rrugën jo vetëm funksionimit të mekanizmit institucional në kuadër të bashkëpunimit rajonal, me qëllim realizimin e financimit të projekteve për të mbështetur aktivitete që inkurajojnë pajtimin, mirëkuptimin reciprok, shkëmbimin e përvojave, vlerat demokratike, pjesëmarrjen, qytetarinë aktive dhe të mësuarit ndërkulturore ndërmjet të rinjve, por edhe të forcimit të stabilitetit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe progresit në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, me qëllim hyrjen në fuqi të saj. Hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje synon të realizojë objektivat e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë të parashikuara në programin e Këshillit të Ministrave për politikën e jashtme, veçanërisht objektivit për thellimin e bashkëpunimit rajonal, si një nga prioritetet kyçe të politikës sonë të jashtme.

Gjithashtu, hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje vjen në përputhje edhe me objektivat e përcaktuara në “Procesin e Berlinit”, “Deklaratën e përbashkët për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në Ballkanin Perëndimor”, nënshkruar më 27 gusht 2015, në Vjenë, Austri, dhe marrëveshjes, ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia), për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor”, bërë në Paris, më 4 korrik 2016, ratifikuar me ligjin nr.118/2016, dhe hyrë në fuqi më 26 korrik 2017.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje i hap rrugë formalizmit të ZRBR, dhe përbën një hap më tej në vizionin e Shqipërisë evropiane si model frymëzimi në rajon, veçanërisht për të rinjtë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ratifikimi i marrëveshjes me vendin pritës ndihmon në zbatimin e “Marrëveshjes ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor”, bërë në Paris, më 4 korrik 2016, ratifikuar me ligjin nr.118/2016, dhe hyrë në fuqi më 26 korrik 2017, e cila ndjek objektivat e përcaktuara si pjesë e “Procesit të Berlinit” dhe “Deklaratës së përbashkët për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në Ballkanin Perëndimor”, nënshkruar më 27 gusht 2015, në konferencën e Ballkanit Perëndimor në Vjenë, Austri, ku është vendosur ngritja e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor, si një strukturë rajonale, e cila udhëheq dhe koordinon bashkëpunimin rinor në rajonin tonë. Theksojmë se angazhimi i Republikës së Shqipërisë në nisma të tilla vjen si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. ZRBR-ja cilësohet si mekanizmi institucional në kuadër rajonal me mandat dhe kapacitet për të krijuar kushtet dhe për të mbështetur aktivitetet që nxisin pajtimin, lëvizshmërinë, diversitetin, vlerat demokratike, pjesëmarrjen, qytetarinë aktive dhe të mësuarit ndërkulturore, me synim influencën në procesin e integritetit evropian në rajon përmes krijimit të mundësive të rinjve që të takohen, të njihen, të krijojnë shoqëri dhe të angazhohen në dialog rajonal në çështje që do t’i mbështesin ata për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë.

Pranimi nga vendet anëtare në ZRBR-së për vendosjen e selisë së tij në Tiranë tregon për kontributin dhe rolin që ka luajtur dhe luan Shqipëria në rajon.

Krijimi i Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor me seli në Tiranë tregon qartazi vullnetin politik dhe vizionin e ri që Shqipëria ka për rajonin. Kjo është një nismë që do të shërbejë si instrument për përshpejtimin e bashkëpunimit rajonal jo vetëm rinor, por edhe më gjerë.

Formalizimi i këtij procesi, nëpërmjet hyrjes në fuqi të marrëveshjes me vendin pritës, përveç rëndësisë në kuadër të bashkëpunimit rajonal, është përfundim i natyrshëm i përpjekjeve të mëdha diplomatike për të sjellë në vend dhe për ta bërë funksionale selinë e një nisme të tillë rajonale.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, Statutit të Marrëveshjes për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor, nënshkruar në Paris, më 4.7.2016, hyrë në fuqi më 26.7.2017, dhe me nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përfron asnjë akt të *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Me ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor, më 4.7.2016, vendet palë, si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Kosova dhe Serbia, dakordësuan për vendosjen e selisë së ZRBR-së në Tiranë. Marrëveshja me vendin pritës, e nënshkruar më 28.8.2018, është bazuar në Statutin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor, pjesë e marrëveshjes për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor.

Marrëveshja është strukturuar me 2 pjesë: në pjesën hyrëse “Preambula” dhe në 24 nene. Pas sqarimit të bërë në nenin 1, për termat që do të përdoren në marrëveshje, nga neni 2 dhe deri në nenin 10, sanksionohen privilegje dhe imunitete, të vlefshme për funksionimin e Sekretariatit të ZRBR-së.

Për sa i përket selisë, neni 2, shteti shqiptar merr përsipër që të ofrojë pa pagesë lehtësitë e nevojshme dhe ambientet e përshtatshme, siç parashikohet në marrëveshjen për ZRBR-në dhe statutin e saj, si pjesë integrale e marrëveshjes.

Në nenin 3 parashikohet rregullimi i “Statusit ligjor” të ZRBR-së, e cila, duke qenë se është themeluar si një organizatë ndërkombëtare, do të gëzojë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji shqiptar dhe do të ketë kapacitetin ligjor të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të tij.

Neni 4 i lejon ZRBR-së të përdorë flamurin dhe simbolet e tij. Për përmbushjen e aktivitetit të tij, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, vendi pritës siguron paprekshmërinë e godinës së ZRBR-së, dokumenteve, materialeve arkivore apo pajisjeve kompjuterike që i përkasin dhe janë në pronësi të ZRBR-së, parashikim i nenit 5.

Në nenet 7 e 8 parashikohet përjashtimi nga taksat për ZRBR-në dhe përdorimi i fondit të tij, në të njëjtat kushte siç është parashikuar për misionet diplomatike të akredituara në Shqipëri.

Duke u bazuar në Konventën e Vjenës, marrëdhëniet diplomatike të vitit 1961, marrëveshjen për themelimin e ZRBR-së, marrëveshja me vendin pritës ka parashikuar rregullimin e privilegjeve dhe të imuniteteve dhe heqjes së tyre, për zyrtarët që do të ushtrojnë aktivitetin e tyre tek ZRBR-ja, rregullime këto të bëra nga neni 10 deri në nenin 17. Masa e privilegjeve të ofruara dhe sasia e imuniteteve që do të gëzojnë do të jetë në përputhje me shkallën e tyre të përfaqësimit.

Në pjesën e fundit janë parashikuar rregullime lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, e cila do të realizohet me negociata mes palëve. Në një nen më vete janë parashikuar dhe ndryshimet e mundshme, si dhe forma e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve.

Vetë marrëveshja, në nenin 22, parashikon si formë të hyrjes në fuqi, ditën kur Republika e Shqipërisë njofton Sekretariatit e ZRBR-së se kanë përfunduar procedurat e brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

Marrëveshja, pas nënshkrimit, në zbatim të neneve 121 e 155, të Kushtetutës, i nënshtrohet procedurës së ratifikimit, pasi ka të bëjë me përjashtim/lehtësim nga taksat.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucioni që ngarkohet me zbatimin e kësaj marrëveshjeje është Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i marrëveshjes nuk sjell efekte direkte nga pikëpamja buxhetore, por jemi në rastin e fitimit të munguar, në kushtet kur ambienti i ofruar për selinë e ZRBR-së pa pagesë është pronë e shtetit shqiptar, e cila administrohet nga

Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik. Gjithashtu, nuk do të vjelë ato tatime dhe taksa për të cilat RYCO dhe stafi ndërkombëtar janë të përjashtuara, pra, miratimi i këtij ligji sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit në një vit, shumën e TVSH-së që mund të kërkohet për rimbursim, përafërsisht rreth 46 576.67 euro.

KËSHILLI I MINISTRAVE